

6987

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYAKTA ERRETHIT TIRANE

NR. 6987

V E N D I M

MBI REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Ne Tirane sot me dt. 27.09.1993 ne gjiqakten e rethit Tirane une gjyqtarja Majlinda Demollari mora ne shqyrtim kerke sen e paraqitur nga kerkusi Ndermarje e rritjes dhe zenies Peshkut Kavaje dhe shoqeria Italiana "T.U.R.I.S.M.A. s.r.l." per krijimin e shoqerise "KAVAJA ACQUACULTURAL PRODUCTION SH.P.K." per regjistrimin e personit juridik.

K O N S T A T O V A

Kerkesen e paraqitur nga kerkusit Ndermarja e rritjes dhe zenies Peshkut Kavaje dhe shoqeria Italiana T.U.R.I.S.M.A. s.r.l. per krijimin e shoqerise me SH.P.K. "KAVAJA ACQUACULTURAL PRODUCTION" per regjistrimin e personit juridik per te ushtruuar veprimitari private ne fushen e kultivimit, zenies dhe tregtimit te peshkut si per vend ashtu edhe per eksport.

Kapitali i shoqerise eshte 1.000 US \$.

Eshte edrejtë dhe ne baze te ligjit duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7638 dt. 19.11.1992

V E N D O S A

Regjistrimin e shoqerise "KAVAJA ACQUACULTURAL PRODUCTION" sh.p.k. me themelues te saj Ndermarjen e rritjes dhe zenies peshkut Kavaje dhe shoqeria italiane T.U.R.I.S.M.A. s.r.l. per te ushtruuar veprimitari ne fushen e kultivimit, zenies, dhe tregtimin e peshkut per vend dhe eksport.

Kunder vendimit lejohet ankrim ne shkalle te dyte.

Tirane me dt. 27.09.1993

Gokoli



GJYQTARE
MAJLINDA DEMOLLARI

F

KONTRATE PËR KRIJIMIN E SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"KAVAJA ACQUACULTURAL PRODUCTION" ME SIGEL "K.A.P. SH.P.K."
ME SELI NË QYTETIN E KAVAJES NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Ndërmjet:

- Ndërmarrjes "Ndërmarrja e Rritjes dhe Zënies së Peshkut Kavajë" pëson juridik që vepron sipas legjislacionit shqiptar dhe me seli në qytetin e Kavajes në Republikën e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Z. Kvjtum Katrosha lindur në Kavajë më 12 tetor 1954, që në këtë akt është i autorizuar me prkurë speciale (lidh.1) dhe,
- Shoqërisë Italiane "T.U.R.I.S.M.A. s.r.l." me seli në Orbetello, Via Gioberti 2A Provinca e Grossetos Itali, përfshirë në Republikën Italiane dhe e regjistruar në Gjykatën e Grossetos në nr.8500 të Regjistrat të Shoqërive, të përfaqësuar nga Z. Vasco Ficulle lindur në Manciano (Grosseto Itali) më 26 tetor 1935 me prokurë të drejtë speciale të lëshuar më datë 24 gusht 1993 nga noter Galgani, regjistri nr.12800 (lidh.2)


Lidhet

si vijon, kontrata për themelimin e një Shoqërie me Përgjegjësi Të Kufizuar që kanë vendosur të krijojnë.

- 1) Shoqëria krijohet dhe e ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në mënyrë të veçantë, por jo ekskluzivisht sipas neve 11 dhe 12 të ligjit nr.7491 të datës 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", sipas ligjit 7638 të datës 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe ligjeve të tjera që do të jenë në fuqi gjatë periudhës së aktivitetit të shoqërisë dhe neneve të Statutit të Shoqërisë që pasi të jetë lexuar dhe aprovuar nga palët i bashkëlidhet dokumentit nr.3
- 2) Emri i Shoqërisë është "Kavaja Acquacultural Production, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" dhe me sigël "K.A.P. SH.P.K."
- 3) Selia e Shoqërisë ndodhet në Kavajë, Lagjja nr.3 në Republikën e Shqipërisë dhe është person juridik shqiptar.
- 4) Objekti i Shoqërisë është:

Rritja e peshkut, konservimi i tij, industrializimi dhe tregtimi i tij brenda Republikës së Shqipërisë dhe Jashtë. Aktiviteti i importimit dhe i eksportimit në përgjithesi dhe i produkteve që kanë të bëjnë me mbarështrimin në veçanti.

Shoqëria mund t'i zhvillojë direkt ose indirekt të gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare, të tundshme dhe të patundshme të nevojshme për vazhdimësinë e qëllimit shoqëror dhe të parashikuara në përgjithësi në Statut me qëllim që të realizojë planet ekonomike dhe financiare për të realizuar fitimin i cili do të ndahet midis ortakëve. Shoqëria mund të marrë pjesë në ndërmarrje ose qëllimi të tij të cilat me këtë blerjes së akioneve ose kuotave.



Përveç aktivitetet e tij cituara më sipër Shoqëria mund të ushtrojë qëdo aktivitet tjetër industrial, tregtar, financiar, të patundshëm, përfshirë këtu edhe atë të marrjes së zonave për ndërtimin dhe bërjen të tregtueshëme të ndërtesave civile dhe industriale të konsideruar të nevojshëm dhe të pështatshëm për qëllimin shoqëror nga ana e Asemblisë së ortakëve.

5) Kapitali shoqëror i Shoqërisë është 100000 Lek dhe i ndarë në kuota me vlerë nominale prej 1000 Lek secila. Kapitali merret dhe nënshkruhet nga ortakët si më poshta:

- NDERMARRJA E KITIJAS DHE ZBNIES SË PESHKUT KAVAJE: 25 kuota baraz me 25.000 Lek;


- T.U.R.I.S.M.A. s.r.l. 75 kuota baraz me 75000 Lek
I gjithë kapitali shoqëror do të derdhet pranë Bankës së Shqipërisë sipas dispozitave në fuqi.

6) Kapitali shoqëror do të rritet me anë të kontributit të të mirave mater-rritet edhe jomateriale nga ana e ortakëve në proporcione kuotat dhe do të shumën e vlerës së terrenit (të përshkruara që të bashkëlli-dhura te nr.4) që pala Shqiptare merr përsipër të dorëzojë në pronësi të K.A.P.SH.P.K. apo të aprovohet ligji shqiptar mbi shitjen e tokës nga ana e Shtetit. Vlerësimi i tokës do të bëhet mbi bazën e terrenit bujqësor meqenëse aktiviteti i kultivimit të peshkut edhe në efekte komunitare është aktivitet bujqësor.

Neqenëse është i nevojshëm që të fillohet menjëherë aktiviteti i rritjes së peshkut nga ana e K.A.P SH.P.K., në pritje të shpalljes së ligjit mbi mënyrat dhe çmimin e shitjes së terrenit, me nënshkrimin e aktit prezent Shoqëria vihet në zotërim të terreneve (të treguara më mirë në dokumentin e lidhur te 4) në pritje që të përcaktohet me ligj çmimi i terrenit dhe të dorëzimi në favor të K.A.P. SH.P.K.

Pala shqiptare në këmbim të dorëzimit të pronës së terrenit do të marrë që kuota të kapitalit shoqëror sa do të jetë vlera që do t'i atribuohet vet terrenit; kontekstualisht pala italiane duke respektuar përqindjen e pjesë-marrjes në kapitalin e K.A.P. SH.P.K. të vendosur në dokumentin present, do të sjellë gjithnjë në emër të rritjes së kapitalit shoqëror, njëte financiare, teknologji etj të importit tri herë më të mëdha se vlera e terrenit të ofruar nga pala shqiptare.

Kapitali i pëllëstar do të rritet shpejt pas krijuarit të shoqërisë me anë të sjelljes së pajisjeve, materialeve dhe të mirave, studimeve të projekteve, të mundshme dhe të marketingut, asistencës dhe drejtimit të punëve, asisten-cess kontabël, sjelljes së materialeve shkencore dhe teknologjive, ndihmë dhe projekte brenda një viti nga dhënia e autorizimit për punë (për palen - tairane, bashkëlidhur në mënyrë treguese te 5), në bazë të inventarve, kontabilitetit, përvogës vërtetimit të efikasitetit dhe mundësive së përcorimit të të mirave (për palen shqiptare bashkëlidhur në mënyrë treguese).



se te 6). Diferenca te mundshme ne vleresim, relativisht ne kapitalin fi te star dhe jo ne rritjet e mepastajme, do te barazohen ne kuadrin e kontr bu te tokes.

Të gjitha sjelljet dhe kontributet duhet te jenë te dokumentuara nga f. Sipas tregullta, ose ne mungesë te tyre nga lista zyrtare te ndermarrjeve deri tuese te makinerive, ose nga bulletine zyrtare te kategorise (shembull: Bulletini Zyrtar i Inxhinjereve Italiane; Ngritje e çmimeve ne Dhomat e Treg isë Zyrtare etj). Per sa i përket huave profesionale specifike që konsulenave te profesionistave e studiuesve që furnizimeve te ndryshme te cilat s'mund te dokumentohen si më poshtë i lihet Këshillave te kategorive respektive ose dhomave te tregtisë te vendosin.

Shoqeria do te administrohet nga një administrator unik. Administratori i parë i emëruar është Z. Vasco Ficulle me mandat tre vjeçar dhe te drejtën per tu rizgjedhur.

Vasco Ficulle i jepen te gjitha kompetencat, që ai pranon, per te kryer te gjitha formalitetet per krijimin e shoqërisë sipas ligjit ne fuqi dhe sipas asaj që është vendosur ne statutin social te bashkëlidhur. Ai është i autorizuar te veprojë ne emër te Shoqërisë që është duke u krijuar deri ne regjistrimin e saj ne Gjykarë, ne veçanti ai është i pajisur me mandat per te vepruar ne emër te shoqërisë te drejta që pas regjistrimit te shoqërisë i kalojnë Shoqërisë.

Përvèç kësaj Administratori është i ngarkuar te kryejë procedurat që janë ne përputhje me objektin e Shoqërisë dhe me kompetencat e saj. Pas regjistrimit te Shoqërisë, keto akte i nënshtrohen gjykimit te ortakëve, jo më vonë se data e mbledhjes se asemblese se parë që kontrollon dhe vendos per kontabilitetin e vitit te parë financiar.

Contrata per krijimin e Shoqërisë është e përbërë prej tre fasesh dhe fjashtë dokumentesh te bashkëlidhura dhe i redaktuar ne shqip dhe italisht ku te dyja kanë te njëjtin efikasitet që vlefshmëri.


Tiranë, më

Ndërmarrja e Rritjes
dhe Zënisë se Peshkut Karabë

Mujtim Kostoshi



T.D.R.I.S.M.A. s.r.l.



I zhvillua se përgjithshë me KAVAJA ACQUAKULTURAL PRODUCTION ME SIGFI "K.A.P. SH.P.K." është që dëgjatet e kavajës me kufizuar e shqiptarë.

Personat që firmosin si vijon:

Z. Kujtim Vatroshi me prokurë të përgjithshë nga njëra anë për ndermarrje "ndermarrja e Britjes dhe Zënjer së Peshkut Kavajë" person juridik që vepron sipas legjislacionit shqiptar që e ka selinë në qytetin e Kavajës në Republikën e Shqipërisë. është
Z. Vas

Per llogari të Shoqërisë italiane "TURISMA s.r.l." me seli në Orbetello Via Ghiberti, 2/A, provinca e Grosseto-Italia në Republikën e Italisë që regjistruar në Cjykatën e Grosseto me Nr. 8500 të Regjistratit të Shoqërive

Lidhin

si vijon, statutin për kriimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar që kanë vendosur të themelojnë.

ARTIKULLI I

FORMA, ETRI I SHQËRISË, OBJEKTI, SELIA, KÖHËZGJATJA

Neni 1

Forma



Shoqëria krijohet dhe e ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe sidomos, por jo ekskluzivisht, sipas neneve 11 dhe 12 të ligjit nr. 7491 të 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" sipas ligjit nr. 7638 të 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe ligjeve të tjera që do të janë në fuqi gjatë periudhës së aktivitetit të shoqërisë, dhe neneve të Statutit të Shoqërisë që është pjesë e pandarë e aktit kushtues.


Neni 2

Emërtimi i shoqërisë

Emri i Shoqërisë është "KAVAJA ACQUAKULTURAL PRODUCTION, SHQIPËRIJA, PLANGJEL GJESI TE KUFIZUAR" që me sigël "K.A.P. SH.P.K."

Neni 3

Objekti



Objekti i shoqërisë është rritja e peshkut dhe konservimi i tij, industrializimi dhe tregtia brenda Republikës së Shqipërisë dhe Jashtë. Aktivitetin e importimit dhe të eksportimit në përgjithësi që nuk mënyrë të vëçantë të prodhimeve që kanë të bëjnë me rritjen, industrializimin që bëren të tregtueshmë të peshkut.

Shoqëria mund të zhvillojë direkt ose indirekt të gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare, të tundshme e të patundshme të nevojshme për arritjen e qëllimit shocëror dhe përgjithësisht të parastikuara në statut me qëllim për të realizuar planet ekonomike që financiare për

35

realizimin e fitimit që do të ndahet dërmjet ortakëve.

Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe të marrë pjesë në fitime në ndërmarrje tjetër e caktuar me shumicë të ortakëve së aksioneve ose kuotave.

Përveç aktivitetave të sipercituara shoqëria mund të ushtrojë çdo aktivitet tjetër industrial, tregtar, financiar, të patundshëm, ku përfshihet edhe marrja e zonave për ndërtimë dhe bërje të tregtueshme të ndërtesave civile dhe industriale të konsideruara të nevojshme dhe të përshtatshme për qëllim shoqëror nga ana e Asembleasë së ortakëve.

Neni 4

Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në Kavajë, Rruge
në Republikën e Shqipërisë.

Shoqëria mund të hapë Filiale, Agjensi dhe seli të përfaqësimit edhe Jashtë Trasferimi nga selia e shoqërisë në një adresë tjetër mund të bëhet me aprovimin e ortakëve me shumicë prej të paktën 3/4 e kapitalit shoqëror.

Neni 5

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar për një periudhë prej 99 vjetësh duke filluar nga data e regjistrimit në Cijkatë

Kohëzgjatje mund të zgjatet përtetj këtijë kufiri dhe mund të ulet me shkrirjen e shoqërisë.

ARTIKULLI II

KAPITALI FILLESTAR, KONTRIBUTI, KUOTAT E KAPITALIT

Neni 6

Kapitali fillestar është 100.000 Lek.

Është i përbërë nga 100 kuota me vlerë 1000 Lek secila.

Në rast rritjeje të kapitalit duke rritur numrin e kuotave, ortakët kanë të drejtën e opsonit për nënshkrimin e tyre proporcionalisht me kuotat e mbajtura. Ortakët mund të refuzojnë ushtrimin e një të drejte të tillë. Derdhja për kuotat e nënshkruara duhet të bëhet me kërkesen e Administratorit.


Shoqëria mund ta reduktojë kapitalin e saj. Zvogëlimi i kapitalit vendoset nga Asemblea e ortakëve me shumicë të ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar, që kanë të paktën 3/4 e kuotave të kapitalit shoqëror. Zvogëlimi i kapitalit poek çdo ortak në të njëjtën masë.

Neni 7

Shitja dhe trasferimi i kuotave:

Kuotat e kapitalit shoqëror janë lirisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve, si trashëgimi, në rast divorci, dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

Kuotat e kapitalit shoqëror mund t'u trasferohen të trëtëve vetëm me aprovimin e shumicës së ortakëve që posedojnë të paktën 3/4 e kuotave të ortakëve jo më te favorshme se ato të propozuara ortakëve.



ARTIKOLII III

VERDINET, ALALINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE

Meni 3

Ortakët dhe Asemblea e Ortakëve

Ortakët e Shoqërisë përballojnë humbjet e saj deri në vlerën e kapitalit shoqëror që posedojnë.

Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asemble-së dhe disponon një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit që ka. Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendimet kolektive, çdo ortak ka të drejtë të jetë i përfaqësuar nga një tjetër ortak ose nga një person i zgjedhur prej tij.

Thirrja e Asemble-së mund të kërkohet nga një ose më shumë ortakë që kanë më shumë se 1/10 e kuotave të kapitalit shoqëror, nga Administratori, nga Kolegji Sindikal n.q.s. ekziston, ose nga likuidatorët. Asembletë e rregullta dhe të jashtëzakonshme do të thirren nga Organi Administrativ, dhe në rast mungese ose pengese, nga një ortak me letër të rekomanduar me dëftesë kthimi dërguar ortakëve në banesat e tyre të paktën dhjetë (15) ditë përpara ditës së fiksuar për asemblenë. Në letër duhet të tregohen vendi, dita dhe ora e mbledhjes dhe lista e materialit që do të trajtohet. Në letër tregohen dita dhe ora për mbledhjen në thirrjen e dytë në rast se e para do të realizohej. Megjithatë janë të vlefshme asembletë totalitare.

Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asemble-së mund të jetë e rregulit ose e jashtëzakonshme. Asemblea e rregullt vendoș për probleme të ndryshme, p.sh. emëron dhe shkarkon administratorët, revizorët e autorizuar dhe likuidatorët, aprovon raportet e administratës dhe të kontrollit, aprovon llogaritë vjetore dhe shpérndan të ardhurat, vendoș për sa i përket trasferimit në të tretë të kuotave të kapitalit shoqëror, dhe më gjërë mbi çdo argument që nuk sjell ndryshime më statutin aktual etj. Asemblea e jashtëzakonshme vendoș për probleme të tjera si zvogëlimi ose rritja e kapitalit shoqëror, rritja e kohëzgjatjes së aktivitetit të shoqëri, ose likuidimin e saj, ndryshimin e tipit të shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në tjetër tip dhe në përgjithësi për çfarëdo argumenti që sjell ndryshime në statutin aktual.

Asemblea e rregulit në mbledhjen e saj të parë mund të vendosë një janx tē pranishëm ose përfaqësuar një numër ortakësh që kanë më tepë gjysmën e kuotave të kapitalit shoqëror dhe vendimet merren me shumicë prej 50% të votave të ortakëve presentë ose të përfaqësuar. N.q.s. mbledhja e parë e asemble-së së rregulit nuk realizohet, mund tē thirret një mbledhje e dytë e cila në mënyrë të vlefshme pavarësisht nga kuotat e kapitalit shoqëtë ortakeve tē pranishëm ose tē përfaqësuar mund tē vendosë dhe vendimet merren me shumicë të tā madhe se 50% e ortakëve presentë ose tē përfaqësuar.

38

Asemblea e jashtëzakonshme kërkon kushte të prezencës ose të përfaqësimit të njëjtë me qio të asembleës të rregullt, si në thirrjen e parë ashtu eche në të dytën, por mund të vendosë në mënyrë të vlefshme vetem me shumicë votash të aq ortakëve sa të përfaqësojnë 3/4 e kapitalit shoqëror. Asembletë drejtohen nga Administratori Unik, ose në mungesë të tij, nga një person i emëruar nga asemblea. Kryetari i Asambleës emëron një Sekretar, qof jo ortak, por që procesverbali të redaktohet nga një noter.

Neni 9

Administrimi:

Shoqëria administrohet nga një administrator unik që duhet të jetë person fizik që mund të mos jetë ortak i shoqërisë.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me aprovimin e shumicës së ortakëve që kanë më tepër se 50% të kuotave të kapitalit shoqëror. Emërimi bëhet përmes periudhës kohe nga një deri në tre ushtrime financiare përvëç rastit të morëheqjes, dhe mund të rizgjidhet.

Në raportet me ortakët dhe të tretët administratori ka të gjitha kompetençat përmes kryer të gjitha procedurat e administrimit që i interesojnë shoqërisë me anë të veprimeve që janë në sintoni me objektin shoqëror, përvëç kompetencave që ligji dhe statuti u rezervojnë ortakëve.

Administratori është përgjegjës kundrejtë shoqërisë ose kundrejtë të tretëve qoftë përmes kundravajtje legale, qoftë përmes kundravajtje kundrejtë statutit ose përmes gabime gjatë administrimit.

Neni 10

Revizorët

N.q.s. do të jetë e nevojshme dhe nëqoftëse ligji e kërkon, kontrolli i shoqërisë duhet të bëhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i emëruar përmes vjetë financiarë me mundësi përmes t'u rizgjedhur nga shumica e ortakëve që përfaqësojnë 1/2 e kapitalit shoqëror.

Revizori mund të shkarkohet me të njëjtat modalitetë me të cilat është emëruar, n.q.s. vërehen gabime gjatë punës dhe kur ai nuk mund të ushtrujë detyrat e tij.

ARTIKULLI IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE, SHPEKTORATË E TË KONTROLUAR

Neni 11

Viti finanziar, llogaritë vjetore:

Veprimet shoqërore mbyllen në 31 dhjetor të çdo viti.

Llogaritë vjetore, inventari, relacionet mbi operacionet e vitit finanziar, relacionet e administratorëve që eventualet të Revizorit të llogarive të autorizuar, aprovohen nga asemblea me shumicën e ortakëve që kërne më tepër se 50% të kuotave të kapitalit shoqëror.

Aprovimi i dokumentave mbi aktivitetin vjetor bëhet brenda një afati menj

Jashtë muajsh nga data e mbylljes së vëprimit shoqëror.

Neni 12

Dividentët

Fas aprovimit të llogarive vjetore, dhe llogaritjes se të ardhurave, asemeblea e ortakëve përcakton pjesën që i takon ortakëve në formën e dividen-
tëve mbi të ardhurat. Fitimi që do të shpërndahet ndërmjet ortakëve në pro-
porcion me kuotat e kapitalit shoqëror, përfaqeson fitimin e vitit finan-
ciar të pastruar nga shumat e kaluara në rezervë (5% e fitimit të çdo viti
deri në arritjen e 1/10 së kapitalit fillestar)

ARTIKULLI V

SHTIMI I KOHËZGJATJES, SHKRIRJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISË

Neni 13

Shtimi i kohëzgjatjes:

Ne skadencën e parashikuar në nenin 5 të statutit prezent, mund të vendoset shtimi i kohëzgjatjes nga asemblea me shumicën e ortakëve që kanë të pakten 3/4 e kuotave të kapitalit shoqëror.

Neni 14

Shkrirja

Shoqëria shkrihet në fund të kohëzgjatjes të parashikuar në statut përveç kur shtohet kohëzgjatja e shoqërisë sipas nenit 13 ose kur shoqëria shkrihet para kohe për arësyte të parashikuara nga liqji ose me vendim të asemblies së jashtëzakonshme të ortakëve.

Shoqëria nuk shkrihet në rast falimentimi të një ortaku, të paafrojnë tij në punë ose të vdekjes së tij.

Neni 15

Likuidimi:

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit në momentin e shkrirjes së së pavarës së zbatuar këtë proces asemblea emëron një ose më shumë likuidatorë të cilët parasesin gjendjen e aktivit dhe të pasivit të shoqërisë, përcaktojnë operacionet e likuidimit dhe mënyrat dhe kohët e likuidimit.

Në fund të procesit të likuidimit asemblea vendos me shumicë të ortakëve jo më të vogël se 3/4 e kuotave të kapitalit shoqëror, mbi bilancin finanziar definitiv, mbi aktin e vlefshmërisë së punës së likuidatorit dhe mbi fundin e operacionit të likuidimit.

Fas pagimit të kreditorëve dhe shpërndarjes së kapitalit shoqëror zotëru-
esve respektivë të kuotave, likuidatori shpërndan kapitalet që mbeten
ndërmjet ortakëve në proporcion me kuotat e kapitalit shoqëror që ata kanë.

ARTIKULLI VI

RENË TË TJSKU

Neni 16

Neni 16

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të kthehet në rje shoqëri kolektive ose me përgjegjësi të ndryshme vetëm me aprovimin unanim të ortakëve ndersa mund të bëhet një shoqëri anonime, me aprovimin e shumicës së ortakëve të cilët posedojnë të paktën 3/4 e kuotave të kapitalit shoqëror.

Neni 17



Arbitrazhi

Të githa kontraditat që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë, ose gjatë likuiçimit ndërmjet ortakëve, ose ndërmjet shoqërise dhe ortakëve, do të zgjidhen nga gjykata kompetente shqiptare.

Neni 18

Ky statut eshtë redaktuar në katër ekzemplarë në gjuhën italiane dhe në katër ekzemplarë në gjuhën shqipe dhe të gjitha kanë të njëjtën vlerë.

Muhamet Hoxha



40